



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS
OSNOVNI SUD GJAKOVA – BASIC COURT OF GJAKOVA

AGJ.I.nr.85/19

Më datë: 08.02.2019

**RAPORTI VJETOR (2018) PËR PUNËN E GJYKATËS THEMELORE NË GJAKOVË
DHE DEGËT E SAJ NË RAHOVEC DHE MALISHEVË**

Gjykata Themelore në Gjakovë gjatë vitit 2018 përkundër rezultateve të arritur është ballafaquar edhe me sfida të natyrës identike nga vitet paraprake e në veçanti në dy degët e saja në Rahovec dhe Malishevë ka një numër të madhe të lëndëve për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve pasi numri i gjyqtarëve në të dy degët nuk është i plotësuar sipas organo gramit.

OBJEKTIVAT E CAKTUARA

Me qëllim të arritjes së efikasitetit më të madhe të kësaj Gjykate në mbledhjen e Kolegjiut është aprovuar plani vjetor i punës për vitin 2018, për Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe degët e saj.

Ndërsa, me qëllim të reduktimit të numrit më të madhe të lëndëve të vjetra është aprovuar plani për zvogëlimin e lëndëve të vjetra gjatë vitit 2018 sipas propozimit të aprovuar në kolegjiut e gjyqtarëve për zvogëlimin e lëndëve të vjetra në të gjitha materiet.

Mbajtja dhe procedimi I të gjitha lëndëve në kohë të arsyeshme dhe në afate ligjore sidomos të lëndëve me paraburgim, masat siguresse dhe lëndë me prioritet ligjor dhe ato me prioritet të kërkuar nga KGJK-ja të dalura nga kërkesat e Komisionit Evropian.

Shfrytëzimi sa më I mire I resurseve njerëzore- në veçanti shpërndarja e gjyqtareve meqë me këtë numër të vogël është dashur të mbulohet secili departament dhe divizion, si dhe stafi mbështetës për punët e gjyqtarëve.

Ngritja e kapacitetit dhe vetëdijes tek të gjithë zyrtarët e gjykatave dhe gjyqtareve në përdorimin dhe shfrytëzimin e teknologjisë informative si objektiv I përgjithshëm gjyqësor për futjen në përdorim të sistemit TIK/SMIL që do të futet në përdorim gjatë viteve në vijim.

Rritja e transparencës dhe hapja e gjykatës për publikun dhe publikimin e informacioneve për aktivitetet dhe punën e gjykatës.

Përballja me procesin e delegimit të kompetencave nga SKGJK-ja në fushën e personelit, financave dhe prokurimit në kompetencat e kësaj gjykate.

Forcimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional të gjykatës me organet tjera relevante për mbarëvajtjen e punës së gjykatës.

SFIDA

Viti 2018 ishte mjaftë sfidues me punën e funksionalizimit të funksioneve të cilat ishte deleguar kompetencat nga SKGJ-ja, në gjykata (personeli, financat dhe prokurimi) sidomos plotësimi i vendeve të punës e sidomos kur kihet parasysh procedurat e gjata nga shpallja e konkursit, shtjerja e mjeteve-ankesave sidomos në KPMSHC-ën, e deri në marrjen e akt emërimit për zyrtarë përkatës.

Si në fillimin të reformimit të gjyqësorit po ashtu edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar të jetë sfiduese formimi i trupave gjykues në krimet e rënda, për shkak të numrit të vogël të Gjyqtarëve dhe angazhimit të Gjyqtarëve në lëndët që janë ngarkuar vet, prandaj duke marruar parasysh që secili Gjyqtar është munduar që të kryej sa më shumë lëndë të cilët ishin ngarkuar vet, në shumë raste është dashur që Gjyqtarët e krimeve të Rënda të ballafaqohem me pritjet e kohë pas kohesh të Gjyqtarëve të Divizioneve tjerë, përfshirë edhe gjyqtarët nga degët e kësaj gjykate për formimin e trupave gjykues. Prandaj, sfide gjatë vitit 2018 ishte funksionimi I papenguar i zhvillim të shqyrtimeve kryesore në Krimet e Rënda dhe në veçanti kryerja sa më shumë e lëndëve civile dhe përmbartimore sidomos lëndë sipas strategjisë shtetërore për reduktim të lëndëve të vjetra dhe ato me prioritet ligjor.

Me theks të veçantë ishte sfiduese edhe puna e gjyqtarëve të materies civile nga selia e Gjykatës në Gjakovë që ishin ri-caktuar për të punuar në Degën në Rahovec në lëndët civile që ishin në punë te gjyqtari i cili që nga muaji Korrik kishte dalë në pension.

VËSHTIRËSIT

1. Mungesa e gjyqtarëve;

Gjykatën Themelore në Gjakovë si në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2018 ka pasur jo-stabilitet sa i përket numrit të gjyqtarëve në dy degët e kësaj gjykate në Rahovec dhe Malishevë në veçanti prej muajit Maj dega e Malishevës ka qenë vetëm me një gjyqtarë penalist njëkohësisht edhe Mbikëqyrësi Gjykatës, meqenëse një gjyqtarë është deleguar me vendim të KGJK-së për të punuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Në Gjykatën Themelore në Gjakovë në vitin 2018 ishin të plotësuar të gjitha vendet për gjyqtarë ashtu si janë përcaktuar me organo gram.

Dega në Malishevë, nga 6 gjyqtare sa duhet të jenë sipas organo gramit gjatë vitit 2018 respektivisht nga muaji Maj ka funksionuar vetëm me 4 gjyqtarë ndërsa gjatë vitit njeri prej gjyqtarëve është emëruar por ka vijuar trajnimin në Akademinë e Drejtësisë dhe deri në përfundim të trajnimit gjatë vitit 2018 ndërsa në gjysmën e II-të muajit Dhjetorit është ngarkuar me lëndë në lëminë penale.

Dega në Rahovec deri në Qershor ka funksionuar me 5 gjyqtar ndërsa nga muaji Korrik me vetëm 4 gjyqtarë edhe pse sipas organo gramit do të duhet të ishin 8 gjyqtarë, edhe pse është emëruar edhe një gjyqtar i cili vijon trajnimin në Akademinë e Drejtësisë dhe deri në përfundim të trajnimit gjatë vitit 2018 ndërsa në gjysmën e II-të muajit Dhjetor është ngarkuar me lëndë në lëminë civile.

2. Mosplotësimi I stafit mbështetës profesional;

Mosplotësimi me bashkëpunëtorë profesional në Gjykatë dhe në degët e saj, ka zbehur mundësinë për një efikasitet më të madh të Gjykatës Themelore gjegjësisht Degët të saja.

Gjykata gjatë vitit 2018 ka hasur në vështirësi në publikimin e konkurseve dhe plotësimin e vendeve të punës për shërbimin civil pasi që hapja e konkurseve nuk na është lejuar gjegjësisht është kthyer për plotësim sipas kërkesave dhe vendeve të lira që kemi pasur meqenëse është kërkuar përshkrimi i detyrave të punës e nga ana e SKGJK-së, e sidomos jemi ballafaquar me pritje të gjata për shkak të procedurave sipas ankesave sidomos në KPMSHC-në, në veçanti në ato pozita ku janë prishur dhe është kërkuar që të anulohen vendimet dhe është rishpallur konkursi për vendet e lira andaj si rezultat i këtyre vështirësive nuk kemi mundur që ti plotësojmë edhe disa vendet e lira në shërbimin civil e kjo është reflektuar edhe në punën e Gjykatës në tersi.

Nuk është arritur që të plotësohen ende pozita e zyrtarit për statistika, arkivist i lart, dhe flete dorëzuesi.

Në degën e gjykatës në Rahovec është zhvilluar procedura e rekrutimit fillimisht sipas konkursit të brendshëm e pastaj edhe të jashtëm dhe është përfunduar i gjithë procesi lidhur me këtë konkurse mirëpo për shkak të afateve për paraqitjen e ankesave në komisionin për ankesa dhe parashtrësia e më pas edhe në KPMSHC-ën, gjatë vitit 2018 nuk është arritur që të emërohet ndihmës administratori i kësaj dege për të cilin pozicion në fazën e pritjes për të përfunduar ky procese është emëruar u.d. ndihmës administrator për periudhën kohore në përputhje me lidhin për shërbyesit civil.

Gjatë vitit 2018, një gjyqtarë i emëruar ka vazhduar të vijon trajnimin në akademinë e drejtësisë deri në muajin Dhjetor kur kanë filluar të punoj në lëmin civile.

Edhe në degë e gjykatës në Malishevë ka mbetur i paplotësuar vendi, sipas në organo gramit të gjykatës - pozita e referentit të lartë e cila në procedurën e ankesë nga KPMSHC-ja është prishur.

Gjatë vitit 2018, një gjyqtarë i emëruar ka vazhduar të vijon trajnimin në akademinë e drejtësisë deri në muajin Dhjetor kur kanë filluar të punoj në lëmin penale.

3. Mungesa e institucioneve;

Duke marrë parasysh se në territorin e juridiksionit të kësaj Gjykate, ishte mungesa e institucioneve- mos ekzistimi i Qendrës së Paraburgimit , falë angazhimit dhe bisedimeve të vazhdueshme dhe në mirëkuptim të udhëheqësve të këtyre institucioneve më të afërta për këtë territor është arritur që të menaxhohet situata e funksionimit të pa penguar e punës së kësaj Gjykate dhe degëve të saj, sidomos në dërgimin dhe pranimin e të dënuarve me dënim burgimi deri në 3 muaj. Rastet nga Gjakova janë dërguar në Qendrën e Paraburgimit në Pejë ndërsa ato të degëve në Rahovec dhe Malishevë janë dërguar në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

4. Papërshtatshmëria e Objektivit të Gjykatës;

Objekti i tanishëm i kësaj Gjykate edhe pse në shikim të parë lenë përshtypje se do të jetë i mjaftueshëm për kapacitetin e punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë, do të ishte një përshtypje jo e drejtë, meqenëse duke u nisur nga mungesa e hyrjes dhe ndalimit – parkimit të

automjeteve zyrtare në veçanti të Njësitit për transportin dhe sjelljen e të paraburgosurve në këtë Gjykatë, është pak e sigurt sjellja e të paraburgosurve nga automjetet e zyrtarëve e deri në objekt-Gjykatë. Mungesa e hapësirës për vendosjen e të paraburgosurve për mbajtje në këtë Gjykatë, respektivisht vendi ku mbahen të paraburgosurit është në sipërfaqe prej 1 m 2 dhe po të ketë parasysh se numri i paraburgosurve që sillen në këtë Gjykatë për mbajtjen e seancave të paraburgimeve, shqyrtimeve fillestare dhe shqyrtimit kryesor të lënë për të kuptuar se ky objekt as për afër nuk i plotëson kushtet më se të domosdoshme për zhvillimin pa pengesë dhe sigurisë së punës në këtë Gjykatë, dhe për këtë arsye edhe shumë gjykime në mungesë të sallave të gjykimit gjyqtarët i mbajnë në zyre të tyre.

Mirëpo, shpresojmë se në vitin 2019 ndoshta do të duhet të jetë i gatshëm objekti i ri që po ndërtohet për këtë gjykatë.

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE MEDIAT

Me qëllim të arritjes së besueshmërisë më të madhe të publikut dhe promovimit të transparencës së kësaj Gjykate edhe gjatë vitit 2018 është vazhduar “dita e hapur për qytetar” që çdo të hënë të javës të pranohen palët e ndryshme lidhur me pretendimet e tyre për ndonjë pa rregullsi apo ankesa ndaj ndonjë zyrtari të gjykatës.

Në hollin e Gjykatës për orientim më të lehtë të palëve janë publikuar në monitor të gjitha seancat për secilën lëmi, e në hyrje të objektit të gjykatës vazhdojnë të jenë të vendosura broshurat që informon qytetarin për organizimin dhe strukturën organizative të Gjykatave në Kosovë.

Në kërkesë për informim media –gazetarët janë dhënë informacionet e caktuara. Po ashtu është mbajtur edhe press konferenca për media për përmbylljen e vitit 2018, ku ishin ftuar mediat lokale dhe qendrore.

Edhe gjatë vitit 2018 Kryetari I Gjykatës ishte prezentë në forumet dhe tryezë pune e ndryshme të organizuar nga OSBE, USAID, etj dhe shoqatat joqeveritare si dhe organizatat për monitorim të punës së gjykatës së bashku edhe me gjyqtarët të lëmi përkatëse.

Po ashtu janë ndërmarrë të gjitha veprime për funksionalizimi e web-faqes së kësaj gjykate duke përditësuar me informata dhe komunikata përkatëse dhe njëkohësisht edhe publikimin e aktgjykimeve të formave të prera në kuadër të afatit 60 ditësh nga forma e prerë e vendimeve gjyqësore.

REZULTATET E ARRITURA

Përkundër sfidave dhe vështirësive të paraqitura gjatë vitit 2018, për shkak të numrit të vogël të gjyqtareve, Gjykata Themelore në Gjakovë ka arritur që ti shënoj këto rezultate;

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - 2018	Lende te pazgjidhura ne fillim te P.R. Nereseni predmeti na pocetku I.P. Unsolved cases at the end of R.P.	Lënde te pranuara ne pune Primljenih predmeta u rad Received cases	Gjithsejt lende ne pune Ukupno predmeta u radu Total cases in process	Lende te zgjidhura ne P.R. Reseni predmeti u toku I.P. Solved cases during R.P	Lende te pazgjidhura ne fund te P.R. Nereseni predmeti na kraju I.P. Unsolved cases at the end of R.P.
Paraprake përgjithshme DP	113	400	513	353	160
Paraprake Krimet e Rënda	45	77	122	80	42
Procedura përgatitore për të Mitur	30	66	96	78	18
Penale të Mitur	12	49	61	48	13
Penale KR.	85	76	161	95	66
Penale	969	924	1893	892	1001
Civile	1012	917	1929	827	1102
Ekzekutim – civile	3640	347	3987	868	3119
Ekzekutim me burg	55	91	146	101	45
Ekzekutimet me gjobë	256	212	468	326	142
Trashëgimore	48	12	60	9	51
Jashtkontestimore	111	224	335	227	108
Lëmia e kundërvajtjes	6451	1397	7848	4637	3211
Ekzekutimet e kundërvajtjes	7099	1624	8723	3852	4871
PP.Prapsime	51	188	239	170	69
GJITHËSEJ	19977	6604	26581	12563	14018

Gjithsejtë lëndë të kryera të të gjitha materieve në vitin 2018, **12563** , lëndë.

LËNDË E STRATEGJISË

Lëndët e kryera të strategjisë shtetërore për vitin 2018 për Gjykatën Themelore Gjakove me degët Rahovec e Malishevë, si në tabelën e poshtëshënuar

Lëmitë	Gjykata Themelore Gjakovë	Dega Rahovec	Dega Malishevë		
Paraprake përgjithshme	0	0	0		
Paraprake Krimet e Rënda	0	0			
Procedurë përgatitore	0	0			
Penale të Mitur	2	0			
Penale KR.	13	0			
Penale	69	122	176		
Civile	127	147	144		
Ekzekutim –civile	603	129	30		
Ekzekutim me burg	11	0	2		
Ekzekutimet me gjobë	83	20	84		
Trashëgimore	2	1	6		
Jashtkontestimore	19	8	13		
GJITHËSEJ	929	427	455		

LËNDË NGA KAPITULLI 31 (KORRUPSIONIT)

Nga Kapitulli 31 nga lëndët e Korrupsionit – janë bartur në vitin 2018 , 13 lëndë janë bartur në vitin 2019, kanë arritur gjatë vitit 2018, 14 lëndë, janë kryer në vitin 2018, 20 lëndë ndërsa në punë kanë mbetur edhe 7 lëndë nga ky kapitull.

NJOHJA E VENDIMEVE TË HUAJA

Gjatë vitit 2018, kanë arritur 135 lëndë, janë kryer 135.

LËNDË TË NDIHMËS JURIDIKE.

65 lëndë të kryera

LËNDË TË NDËRMJETËSIMIT.

5 lëndë të referuara , të gjitha janë në procedim nga ndërmjetësuesit.

TË HYRAT TOTALE TË KËSAJ GJYKATE.

Gjykata Themelore në Gjakovë dhe degët e saj Rahovec dhe Malishevë, kanë realizuar të hyrat gjithsejtë: **799,508.32 €**.

DEGA RAHOVEC, gjatë vitit 2018 ka arritur të shënoj këto rezultatet e punës edhe pse ka pasur numër më të vogël të gjyqtarëve se sa ato që parashihen me Organo gram të KGJK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - DEGA RAHOVEC RAPORTI I PERGJITHSHEM PER JANAR-DHJETOR, 2017	Lende te pazgjidhura ne fillim te P.R. Nereseni predmeti na pocetku I.P. Unsolved cases at the end of R.P.	Lende te pranuar ne pune Primljenih predmeta u rad Received cases	Gjithsejt lende ne pune Ukupno predmeta u radu Total cases in process	Lende te zgjidhura ne P.R. Reseni predmeti u toku I.P. Solved cases during R.P	Lende te pazgjidhura ne fund te P.R. Nereseni predmeti na kraju I.P. Unsolved cases at the end of R.P
Paraprake	0	30	30	30	0
Penale	1053	508	1561	618	943
Civile	1252	440	1692	458	1234
Ekzekutim –civile	2300	492	2792	454	2338
Ekzekutim me burg	3	6	9	4	5
Ekzekutimet me gjobë	90	161	251	135	116
Trashëgimore	91	18	109	12	97
Jashtkontestimore	100	89	189	103	86
Kundërvajtja	5768	1084	6852	2851	4001
Ekzekutime të Kundërvajtjes	6353	2042	8395	2912	5483
PP.Prapsime	88	212	300	99	201
GJITHËSEJ	17098	5082	22180	4526	17654

Gjithsejtë lëndë të kryera të të gjitha materieve për vitin 2018 , 4526 lëndë

DEGA MALISHEVË, gjatë vitit 2018 ka arritur të shënoj këto rezultatet e punës edhe pse ka pasur numër më të vogël të gjyqtarëve se sa ato që parashihen me Organo gram të KGJK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË RAPORTI I PERGJITHSHEM PER JANAR- DHJETOR, 2018	Lende te pazgjidhura ne fillim te P.R. Nereseni predmeti na pocetku I.P. Unsolved cases at the end of R.P.	Lende te pranuara ne pune Primljenih predmeta u rad Received cases	Gjithsejt lende ne pune Ukupno predmeta u radu Total cases in process	Lende te zgjidhura ne P.R. Reseni predmeti u toku I.P. Solved cases during R.P.	Lende te pazgjidhura ne fund te P.R. Nereseni predmeti na kraju I.P. Unsolved cases at the end of R.P
Paraprake	76	106	182	102	80
Penale	920	455	1375	427	948
Civile	1085	449	1534	382	1152
Ekzekutim –civile	1679	380	2059	283	1176
Ekzekutim me burg	5	1	6	5	1
Ekzekutimet me gjobë	207	111	318	242	76
Trashëgimore	29	6	35	16	19
Jashtkontestimore	101	142	243	142	101
Kundërvajtje	3604	902	4506	3432	1074
Ekzekutimet e kundërvajtjes	4957	888	5845	3136	2709
PP.Prapsime	64	58	122	50	72
GJITHËSEJ	12727	3498	16225	8217	8008

Gjithsejtë lëndë të kryera të të gjitha materive për vitin 2018, 8217 lëndë

Gjykata Themelore në Gjakovë dhe degët e saj në Rahovec dhe Malishevë edhe gjatë vitit 2019 pret që ti ketë sfidat e ngjashme si gjatë vitit 2018 por me shprese se do të zbuten vështirësitë me të cilat është ballafaquar gjatë vitit 2018 në veçanti të resurseve njerëzore, pasi që janë emëruar dy gjyqtar një në degën në Rahovec dhe njëri në Malishevë ndërsa në fillim të vitin 2019 është emëruar edhe një gjyqtarë i cili do të duhet gjatë këtij viti të vijoj trajnimin në Akademinë e Drejtësisë dhe shpresojmë që gjatë vitit 2019 do të publikohen konkursi edhe për pozita tjera për gjyqtarë pasi që në funde të këtij viti do të ketë pensionim të gjyqtarëve dhe atë një në Degën në Malishevë dhe një në Degën në Rahovec , si dhe me hartimin e organo gramit dhe përshkrimin e detyrave të punës do të arrimë ti mbulojmë vendet e lira të punës edhe në shërbimin civil të Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët e saja në Malishevë dhe Rahovec.

Gjithashtu duhet ta sjellim në vëmendje se edhe gjatë këtij viti do të vazhdohet të avancohet me përdorimin dhe implementimin e TIK/SMIL si një prej objektivave më të pritura të gjyqësorit të Kosovës.

Me respekt!

KRYETARI I GJYKATËS

Vaton Durguti